

FJALA E DEPUTETIT VULLNET SINAJ

E ENJTE 14 TETOR 2021

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Të nderuar qytetarë,

Në fjalën time të parë në legjislaturën X do të doja të përcillja me shumë përvullje dhe respekt një falënderim për të gjithë qytetarët, të cilët më 25 prill me votën e tyre zgjodhën për herë të tretë Partinë Socialiste, si alternativën më të mirë për qeverisjen e vendit! Ndihem i nderuar, që edhe banorët e qarkut të Vlorës vlerësuan punën dhe vëmendjen e shtuar të qeverisë dhe bënë zgjedhjen e duhur. Të nderuar qytetarë, Besimi që na dhatë na bën më të përgjegjshëm për të mbajtur zotimet tona dhe për të përfunduar reformat dhe punët e nisura. Kam kënaqësinë që rigjeta në këtë sallë miq e kolegë nga legjislatura e kaluar, të cilët rifituan mandatet e përfaqësimit! Respekt e mirënjohje për ish-kolegët e mi deputetë të qarkut të Vlorës, për punën e mirë që bënë në këtë qark, në interes të qytetarëve! Gjithashtu, ju uroj suksese deputetëve që janë ulur në këto ndenjese për herë të parë! Jam i bindur se tek ata ka filluar të ndihet pesha e përgjegjësisë që ky institucion na ka vënë mbi shpatulla. Nuk mund ta fsheh bindjen se funksionimi i plotë i parlamentit, së bashku me opozitën, do t'i japë një ritëm tjetër punës sonë legjislative dhe përfaqësimit të drejtë e korrekt të vullnetit të popullit.

Të nderuar deputetë, Ndryshimet në ligjin "Për të huajt" janë rrjedhojë e detyrimeve që ka Shqipëria ndaj procesit të integritetit dhe përafrimit të legjislacionit të saj me BE-në. Në këtë kontekst, opozita e Presidentit dhe e opozitës për këtë ligj është tërësisht politike. Ky ligj nuk ndikon në largimin e shqiptarëve, por synon krijimin e një mjedisi të shëndetshëm për biznesin, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të turizmit. Emigracioni nuk është problematik vetëm e Shqipërisë, por e të gjitha vendeve të rajonit, madje edhe e vendeve të BE-së. Jo vetëm shqiptarët, por edhe shtetasit e këtyre vendeve emigrojnë në vende më të zhvilluara. Megjithatë, nuk është e vërtetë që qeveria nuk ka një strategji për të luftuar fenomenin e emigracionit, siç shprehet Presidenti. Qeveria ka hartuar Strategjinë Kombëtare për Migracionin dhe planin e veprimit 2019-2022, që synojnë të menaxhojnë më mirë tregun kombëtar të punës, duke ofruar stimuj për rikthimin e emigrantëve. Risetë që sjell ky projektligj konsistojnë në tri drejtime: së pari, në procedurën e dhënies së vizave; së dyti, në procedurën e miratimit të lejeve të qëndrimit në Shqipëri; së treti, në procedurën e punësimit të të huajve në Shqipëri. Koncepti i vizës digjitale, që parashikohet në këtë projektligj, sipas të njëjtës metodë që përdoret edhe nga vendet e BE-së, e lehtëson procesin e lëshimit të vizave, si dhe e përshpejton atë. Të huajt mund të aplikojnë online për vizë elektronike, pa qenë të detyruar të paraqiten fizikisht pranë konsullatave apo ambasadave. Si rrjedhojë, viza elektronike do të rrisë numrin e turistëve dhe të shtetasve të huaj që synojnë të bëjnë biznes në Shqipëri. Lidhur me procedurën për dhënien e lejeve të qëndrimit, parashikohet ndërthurja e lejes së punës me lejen e qëndrimit si një e vetme. Te procedura e punësimit të të huajve, risi është edhe shtimi i kategorive të tjera, si: studentët dhe kërkuesit shkencorë, të cilët mund të qëndrojnë deri në 9 muaj pas mbarimit të afatit të studimeve ose kërkimeve, në mënyrë që të kenë mundësi të aplikojnë për punë apo për të krijuar një biznes në Shqipëri. Projektligji lehtëson pajisjen me leje qëndrimi edhe për kategoritë e të huajve, të cilët kanë hasur vështirësi në të shkuarën, si: bashkimet familjare, pensionistët, kategoritë

në nevojë, të rinjtë nga mosha 18-30 vjeç, që kanë interes për të mësuar gjuhën shqipe, kulturën apo historinë tonë, të cilët priten nga një familje shqiptare në këmbim të punëve të lehta shtëpiake.

Të nderuar deputetë, Shqipëria së bashku me vendet e tjera të rajonit, është e angazhuar në implementimin e tregut të përbashkët rajonal, i cili ka në themel 4 fusha kryesore: lëvizjen e lirë të mallrave, të kapitalit dhe të njerëzve; investimet në rajon; integrimin digjital, si dhe inovacionin. Për këtë qëllim integrimi ekonomik brenda rajonit dhe në BE është i rëndësishëm edhe në kontekstin e rimëkëmbjes ekonomike nga efektet negative të pandemisë. Shqipëria po kërkon të zhvendoset drejt një modeli të bazuar të produktivitetit e të orientuar drejt eksportit, në të cilin kërkimi dhe inovacioni janë një pjesë integrale e politikave të zhvillimit. Për këtë arsye ligji “ Për të huajt” do të ndihmojë në rritjen cilësore të tregut të punës dhe në zhvillimin e mëtejshëm të biznesit dhe turizmit në vend. Prandaj, ju ftoj ta rrëzojmë dekretin e Presidentit, duke i hapur kështu rrugë miratimit të këtij projektligji! Faleminderit!